

FJALA E DEPUTETIT VANGJEL DULE

E ENJTE 9 QERSHOR 2022

E nderuar kryesuese e seancës,

Të nderuara kolege dhe kolegë deputetë,

Jetojmë në kushtet e një paqëndrueshmërie të madhe ekonomike dhe financiare, që është fenomen botëror. Dëgjojmë argumentet e Kryeministrit, të anëtarëve të kabinetit, se ne i akuzojmë për konjunkturë ndërkombëtare. Jo, zotërinj! Jemi seriozë me veten, me institucionin ku jemi pjesëtarë, si dhe, në radhë të parë, kemi respekt për ata që na dëgjojnë. Nuk ju kemi akuzuar as për pasojat e pandemisë, as për pasojat e evazionit rus në Ukrainë; ju akuzojmë për mungesën e aftësisë dhe të vullnetit për të lexuar dhe për të kuptuar realitetin në të cilin jetojmë. Duke mos qenë në gjendje dhe duke mos pasur këtë vullnet, ju jeni krejtësisht të paaftë për të ofruar zgjidhje. Nuk është për të qeshur, është për të qarë!

Kujtoj debatin e seancës së 31 marsit, ku një prej anëtarëve të kabinetit, në rolin e profeteshës, na thoshte se këto janë situata ekonomike dhe financiare afatshkurtra, ndërsa sot thonë vlerësime të tjera. Më lejoni t’u referohem disa deklaratave, nga ato që nuk besoj se elita akademike e republikës që gjendet në kabinet i kupton (sepse kohët e fundit shoh se po na japin nga kjo tepri akademike këshilla dhe vërejtje cinike të stilit “nuk kuptoni ato që lexoni, apo nuk kuptoni ato që thoni”) dhe t’ju them se i pari i JPMorgan Chase, James Dimon (nuk e citoj ngaqë ka origjinë greke, mos më keqkuptoni, por për pozicionin e tij) para një jave theksonte: “Kam thënë se ka re shtrëngate, por do ta ndryshoj, është tajfun” dhe në debatin që pati me investitorët dhe analistët tha: “Këshilla që kam për ju është të kujdeseni për veten”.

Pra, biznesmenët dhe analistët duhet të kujdeshin për vete. Po qeveritë përse duhet të kujdesen?! Si në çdo krizë ka edhe nga ata që humbasin, edhe nga ata që fitojnë. Këtë nuk mund ta mohojmë. Nuk dëgjova asnjë nga ministret të thoshte se ka edhe nga ata që fitojnë në kohë krize. Një nga përfituesit është buxheti i shtetit, e pranoni ju, e theksova edhe në debatin

e para 2-3 javëve, por rëndësi ka me kë janë qeveritë, me ata që fitojnë apo me ata që humbasin. Më lejoni t'ju jap disa shembuj. Qeveria gjermane, përpara disa ditësh, më 1 qershor mori disa masa. Për shembull, për 3-mujorin qershorgusht për të gjithë qytetarët pa dallim caktoi një tarifë prej 9 eurosh për transportet e të gjitha llojeve dhe niveleve: 9 euro për 3 muaj, e dyta, uli taksën e karburanteve, që pati një efekt të menjëhershëm në pikat e shitjes me pakicë, konkretisht 30 cent më pak për benzinën, 14 cent më pak për diesel-in.

Intrasixhenca dhe refraktariteti i këtij kabineti dhe i këtij Kryeministri neve na thotë, në të gjitha tonet dhe në të gjitha nivelet: “taksat e naftës, citoj Kryeministrin, nuk do të hiqen dhe këtë nuk ka protestë me drita Iphone-i dhe bllokim rrugësh me goma X5-e që e zhbën”. Ky është Kryeministri. Të gjithë qytetarët që vuajnë pasojat e krizës, janë nga ata që kanë Iphone dhe X5. Dëgjoni se çfarë thotë zëvendëskancelari i Gjermanisë dhe në të njëjtën kohë ministri i Ekonomisë, Robert Habeck: “Nuk mund të them sesa masat e qeverisë do të mjaftojnë për të garantuar paqen sociale dhe ndjenjën e qytetarëve se jetojmë në një shoqëri të drejtë”. A e shikoni dallimin? Zëvendëskancelari vjen nga të gjelbërit, në fakt.

Kush mendon për humbësit nga kjo krizë dhe kush mendon për fituesit nga kjo krizë? T'ju citoj edhe masat e Kryeministrit Mitsotakis. Prapë ritheksoj se te fituesit nga kriza ka fitime të jashtëzakonshme. Qeveria greke sanksionon tatim të jashtëzakonshëm. “Të gjitha ato kompani, kryesisht të energjisë, që gjatë vitit aktual kanë fitime të jashtëzakonshme, do të kenë një tatim të jashtëzakonshëm, për t'u ardhur në ndihmë pjesës tjetër të qytetarëve”. Tani vijmë tek aspekti tjetër. Na thuhet se në vendin tonë nuk do të preket taksa e naftës për të mbajtur të pandryshueshëm çmimin e energjisë elektrike. Se sa i pandryshueshëm është, e shohin në çdo llogari mujore vetë qytetarët dhe çdo familje.

Ne në kushtet tona, ku prodhimi bazohet në burime hidrike, e kemi shumë më të lehtë ta mbajmë të pandryshueshëm, por edhe vendet që e kanë kryesisht nga përdorimi i gazit dhe hidrokarbureve. Prandaj dua t'ju them se shumë qeveri i bëjnë të dyja, edhe çmimin e energjisë elektrike e subvencionojnë, edhe çmimin e karburanteve e kanë ulur, ose e kanë mbajtur nën kontroll. Mos e harroni, meqë doni të jeni të përditësuar me zhvillimet e vendeve të rajonit dhe

më gjerë, e quajnë fuel pass, është një financim mujor për të gjithë konsumatorët si të benzinës, ashtu edhe të diesel-it.

Zonja dhe zotërinj,

Duket qartësisht që ju nuk jeni zgjedhur nga vota e qytetarëve, që në lojën dhe ekuacionin e krizës t'ju shërbeni interesave të tyre. Ju jeni të bindur, ju jeni të ndërgjegjshëm se jeni zgjedhur nga paratë e oligarkëve, që juve ju kanë subvencionuar blerjen e votës, për rrjedhojë jeni luajalë në shërbimin që u bëni atyre. Në këto kushte, ju që thoshit se, citoj Kryeministrin tuaj, qeveria ka hequr dorë nga kontrolli i çmimit të tregut që prej vitit 1990, shteti nuk vendos dhe nuk imponon dot çmime; nuk kaloi as java kur na thatë se nuk do të ketë asnjë tabelë, në asnjë pikë karburanti, ku do të shfaqet një çmim, që nuk është miratuar nga bordi. Vendosni çfarë jeni! Vendosni një fillim, vendosni një mes, vendosni një fund dhe na thoni mos jini skeptikë.

Në kushtet globale të kësaj krize, dhe e theksoj, për të cilën nuk ju vëmë faj se jeni ju shkaktarë, ju akuzojmë për cinizëm, për paaftësi, për anshmëri dhe, mbi të gjitha, për klientelizëm, jo se i keni ju klientë tashmë bizneset që favorizoni, jeni ju klientët e atyre bizneseve. Në këtë rreth vicioz e keni futur vendin, shoqërinë dhe e ardhmja bëhet edhe më e vështirë. Në këto kushte do të dëshiroja t'ju kujtoja kolegëve të mi të opozitës fabulën që nga ky podium përmenda përpara disa javësh, mos e harroni: "Gjahtari, të cilin disa e thirrën në ndihmë në konfliktin që pati me drerin, e ka vënë frerin për së mbari".

Duhet stërmundim që të hiqet nga opozita ky fre; duhet të unifikohemi; duhet të mbështesim çdo lëvizje qytetare; duhet të koordinohemi me shoqërinë civile, sepse këtyre nuk u djersin veshi nga çfarëdo që dëgjojnë dhe nga çfarëdo që ne mund të themi nga ky podium, apo nga protestat qytetare nëpër bulevarde. Faleminderit!